



Bazuar nenin 35 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010) si dhe nenit 49 dhe nenit 85 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2019, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT KREDITOR**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të përcaktojë standardet dhe kërkesat minimale për menaxhimin e rrezikut kreditor, praktikën e shëndosha të rrezikut kreditor dhe zbatimin e vazhdueshëm të kornizës së kontabilitetit të mbështur në humbjet e parashikuara të kredive (HPK).
2. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në Nenin 3 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare" (në vijim: Ligji për banka), dhe/ose sipas përkufizimeve në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
  - 1.1. **Rezerva për humbjet nga kreditë** - nënkupton provizionet për humbjet nga kreditë që janë njohur në bilancin e gjendjes së bankës në përputhje me SNRF-të;
  - 1.2. **Derivativ** - nënkupton një instrument financiar, çmimi i të cilit rrjedh nga një aset tjetër;
  - 1.3. **Humbjet e parashikuara kreditore (HPK)** - nënkupton probabilitetin e peshuar të humbjes kreditore gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar;

- 1.4 **Ekspozim** - nënkutpon çdo aset ose zë jashtë bilancor, duke përfshirë pa kufizim ndonjë kredi apo zotim direkt ose indirekt për pagim të parasë në shkëmbim të së drejtës për kthim të shumës së paguar dhe të mbetur dhe për pagesën e interesit apo, shpenzimeve të tjera që lidhen me këtë shumë, çdo shtyrje të datës së pagimit të borxhit, çdo garancion apo letër-kredi të lëshuar, letra me vlerë të borxheve dhe forma të ngjashme të kreditimeve apo zotimeve për kreditime të dhëna nga banka për klientin, si dhe aksionet, pjesëmarrjen në kapital dhe llojet tjera të investimeve në një person juridik nga banka;
- 1.5 **Ekspozimet kreditore** - nënkuptojnë kreditë, zotimet e kredive dhe garancionet financiare për të cilat zbatohet HPK;
- 1.6 **Zërat jashtëbilancor** - nënkuptojnë obligimet kontingjente të bankës duke përfshirë zëvendësuesit direkt të kredive të lejuara nga banka si garancione borxhi, letër kredi në pritje dhe kontingjentet tjera të cilat duhet të shpalosen si fusnota në bilancin e gjendjes, por për të cilat nuk ka vlerë rreziku definitive për qëllim të përfshirjes në pjesët kryesore të bilancit të gjendjes;
- 1.7 **Rregullimet e përkohshme të rezervave** - nënkuptojnë përshtatjet në rezervën për humbjet nga kreditë që mund të përdoren për përlogaritje vetëm në rrethanat kur bëhet e qartë se faktorët e rrezikut ekzistues ose të pritur nuk janë marrë në konsideratë në procesin e vlerësimit dhe modelimit të rrezikut të kredive në datën e raportimit.

### **Neni 3**

#### **Sistemi i Menaxhimit të Rrezikut Kreditor**

1. Bankat duhet të kenë një sistem për menaxhimin e rrezikut kreditor, që është i përshtatshëm për natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e aktiviteteve të tyre.
2. Sistemi i menaxhimit të rrezikut kreditor në banka duhet të përfshijë politikën, procedurat, rregullat dhe strukturën të cilat përdoren nga bankat për të menaxhuar rrezikun kreditor.
3. Sistemi i menaxhimit të rrezikut kreditor duhet që në mënyrë të vazhdueshme dhe me kohë të bëjë vlerësimin e kualitetit të kredive dhe mjeteve tjera, duke përfshirë edhe përcaktimin e adekuatshmërisë së rezervave për humbjet që lidhen me këtë rrezik.

### **Neni 4**

#### **Strategjitë dhe Politikën**

1. Banka duhet të zhvillojë strategji dhe politikë për të menaxhuar rrezikun kreditor. Strategjia dhe politika për menaxhimin e rrezikut kreditor duhet të komunikohen në mënyrë efektive në tërë bankën. I gjithë personeli përkatës duhet qartë të kuptojë qasjen e bankës për dhënien dhe menaxhimin e kredive dhe duhet të mbahen përgjegjës për pajtueshmëri me politikën dhe procedurat e përcaktuara.

2. Qëllimi bazë i strategjisë së rrezikut kreditor është të përcaktojë gatishmërinë e bankës për të marrë rrezik. Pasi niveli i rrezikut të jetë vendosur, banka mund të zhvillojë një plan për të optimizuar kthimin duke e mbajtur rrezikun kreditor brenda kufijve të paracaktuar. Strategjia e rrezikut kreditor duhet të përbëhet në minimum nga:
  - 2.1. Deklarata e gatishmërisë së bankës për të dhënë kredi bazuar në segmente të ndryshme të huamarrësve dhe të produkteve, të llojit të ekspozimit (tregtare, të prodhimit, të konsumit, pasurive të patundshme, etj.), sektori ekonomik, vendndodhja gjeografike, valutës, afatit të maturimit dhe profitabilitetit të parashikuar;
  - 2.2. Identifikimi i tregjeve të synuara dhe karakteristikat e përgjithshme që banka planifikon t'i arrijë në portofolin e saj të kredisë, duke përfshirë nivelet e diversifikimit dhe tolerancën e koncentrimit;
  - 2.3. Njohja me objektivat e kualitetit të kredive, fitimeve dhe rritjen;
  - 2.4. Sigurimi i vazhdimësisë së qasjes që duhet të marrë parasysh aspektet ciklike të ekonomisë dhe lëvizjeve që rezultojnë në përbërjen dhe kualitetin e portofolit të kredive.
3. Strategjia e rrezikut kreditor duhet të rishikohet në baza të rregullta, të paktën një herë në vit.
4. Politika për menaxhimin e rrezikut kreditor duhet të rishikohet në baza të rregullta, të paktën një herë në vit dhe së paku duhet të përfshijë elementet vijuese:
  - 4.1. Misionin;
  - 4.2. Përcaktimin e llojeve të pranueshme dhe të papranueshme të ekspozimeve kreditore;
  - 4.3. Kufizimi i totalit të kredive aktive në raport me mjetet totale, depozitat apo kapitalin;
  - 4.4. Kombinimi i portofolios së dëshiruar;
  - 4.5. Shpërndarja e portofolios sipas afatit të maturimit të kredive;
  - 4.6. Segmentimi i definuar i tregut;
  - 4.7. Kushtet e huadhënies: çmimi, afati i kthimit, dhe pagesat paraprake/kërkesat kapitale;
  - 4.8. Informatat financiare të kërkuara;
  - 4.9. Përkufizimi i një huamarrësi të kualifikuar për kredi;
  - 4.10. Kolaterali i pranueshëm dhe margjinat;
  - 4.11. Autoritetet e huadhënies dhe procesi i aprovimit;
  - 4.12. Kufizimet mbi ekspozimet e mëdha;
  - 4.13. Limitet për zyrtarë kreditor lidhur me portofolin e tyre kreditor;
  - 4.14. Ekspozimet e personave të brendshëm dhe interesat e ndërlidhura të tyre;
  - 4.15. Udhëzime për ri programim të kredive;

- 4.16. Raporte të brendshme lidhur me menaxhimin e rrezikut kreditor;
- 4.17. Organizimi i funksionit të huadhënies;
- 4.18. Udhëzime për blerjet dhe shitjet e kredive me pjesëmarrje të përbashkët të institucioneve financiare.

## **Neni 5**

### **Struktura Organizative për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor**

1. Banka duhet të krijojë strukturë të përshtatshme organizative për menaxhimin e rrezikut kreditor, duke përcaktuar qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese.
2. Banka duhet të sigurojë që funksioni i shitjes së kredive, të jetë i ndarë në mënyrë të qartë, nga pikëpamja organizative dhe operative, nga funksionet mbështetëse operationale dhe ato të kontrollit të rrezikut kreditor, duke përfshirë pavarësinë nga ndikimet e mundshme nga nivelet e larta drejtuese.
3. Banka duhet të sigurojë strukturën e nevojshme për vlerësimin, matjen dhe kontrollin e koncentrimin të rrezikut kreditor sipas sektorëve, sipas shtrirjes gjeografike/ lokacionit, sipas valutës, llojit të kredisë, etj.
4. Bordi i drejtorëve të bankës është përgjegjës për miratimin dhe rishikimin e rregullt të strategjisë së menaxhimit të rrezikut kreditor dhe politikave e proceseve për identifikimin, matjen, vlerësimin, monitorimin, raportimin dhe zbutjen e rrezikut kreditor në përputhje me gatishmërinë për të marrë rrezik të përcaktuar nga bordi. Gjithashtu, Bordi i drejtorëve të bankës do të kërkojë nga menaxhmenti i lartë që të miratojë dhe t'i përmbahen praktikave të shëndosha në lidhje me lejimin dhe menaxhimin e kredive.
5. Bordi i drejtorëve i bankave, në lidhje me menaxhimin e rrezikut kreditor është përgjegjës të:
  - 5.1. Miratojë strategji të rrezikut kreditor;
  - 5.2. Miratojë politikën për menaxhimin e rrezikut kreditor dhe të monitorojë zbatimin e saj;
  - 5.3. Rishikojë përshtatshmërinë e politikës dhe procedurave të aprovuara, të paktën në baza vjetore;
  - 5.4. Të rishikojë raportet e rrezikut kreditor;
  - 5.5. Të paktën çdo tremujor, bordi i drejtorëve duhet të informohet mbi ekspozimet e rrezikut kreditor (duke përfshirë edhe zërat jashtë bilancor) të bankës dhe duhet të rishikojë, në minimum këto çështje:
    - 5.5.1. Shumën e ekspozimeve të ndërmarra në aktivitetet e kredive, të ndara sipas kategorive (llojin e ekspozimit, produkteve dhe kategorinë e klasifikimit);
    - 5.5.2. Ekspozimet e mëdha kreditore;

- 5.5.3. Listën e kredive me vonesa e cila identifikon problemet dhe humbjet e mundshme të bankës për çdo kredi të rëndësishme;
- 5.5.4. Statusin e kredive të ristrukturuara;
- 5.5.5. Kreditë me rritje shumë të lartë dhe të shpejtë në portofolin kreditor;
- 5.5.6. Raportet mbi përjashtimet e kredive nga politikat dhe procedurat;
- 5.6. Në baza vjetore, bordit të drejtorëve duhet t'i dorëzohet një raport që përmban një listë të të gjitha produkteve kreditore. Raporti duhet të përmbajë, në minimum tregjet e synuara të produkteve kreditore, performancën e tyre dhe kualitetin e kredive.
- 5.7. Në bazë vjetore apo më shpesh, bordi i drejtorëve duhet të rishikojë rezultatet e stres testit për këto çështje:
  - 5.7.1. Përmirësimin e strategjisë dhe politikën e menaxhimit të rrezikut kreditor;
  - 5.7.2. Hartimin dhe përmirësimin e kornizës së kërkuar rregullative për të adresuar çështjet kryesore që lidhen me ekspozimet e rrezikut kreditor;
  - 5.7.3. Parashikimin në kohën e duhur të kërkesave për rritjen e kapitalit dhe identifikimin e mënyrave më të efektshme për akumulimin e tij.
- 5.8. Bordi i drejtorëve të bankave, në lidhje me menaxhimin kreditor është gjithashtu përgjegjës që të:
  - 5.8.1. Aprovojë limite të ekspozimeve ndaj rrezikut kreditor, në përputhje me rregulloren e BQK-së mbi ekspozimet e mëdha;
  - 5.8.2. Definojë përjashtimet e mundshme prej limiteve të përcaktuara dhe të caktojë përgjegjësinë për të vendosur në rastet e aplikimeve të përjashtimeve të tilla;
  - 5.8.3. Monitorojë efikasitetin e kontrolleve të brendshme, si pjesë përbërëse e sistemit të menaxhimit të rrezikut kreditor.
- 6. Komiteti i menaxhimit të rrezikut duhet të:
  - 6.1. Monitorojë politikën e menaxhimit të rrezikut kreditor dhe të japë propozime për rishikimin e vazhdueshëm të saj;
  - 6.2. Vlerësojë sistemin e menaxhimit të rrezikut kreditor;
  - 6.3. Analizojë raportet mbi ekspozimet e bankës ndaj rrezikut kreditor dhe të monitorojë menaxhimin e këtij rreziku;
  - 6.4. Përcaktojë dhe rishikojë rregullisht treguesit e brendshëm kreditor dhe limitet e ekspozimeve ndaj rrezikut kreditor;
  - 6.5. Bëjë përshkrim të qartë të linjave të autoritetit dhe përgjegjësisë për menaxhimin e rrezikut kreditor.

7. Menaxhmenti i bankës duhet të:
  - 7.1. Aprovojë dhe monitorojë zbatimin e procedurave të menaxhimit të rrezikut kreditor;
  - 7.2. Krijojë një ambient për përcjelljen e politikës së menaxhimit të rrezikut kreditor;
  - 7.3. Krijojë një sistem adekuat të raportimit te bordi i drejtorëve dhe komiteti i menaxhimit të rrezikut për çdo mos pajtueshmëri me limitet e ekspozimeve ndaj rrezikut kreditor;
  - 7.4. Krijojë kanale të duhura të komunikimit për të siguruar se politika për menaxhimin e rrezikut kreditor dhe tolerancat e rrezikut kreditor janë komunikuar qartë dhe respektohen nga nivelet e përshtatshme të bankës;
  - 7.5. Sigurojë procedura operacionale adekuate dhe efektive, kontrollë të brendshme dhe sisteme për identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e rrezikut kreditor për të zbatuar politikat e menaxhimit të rrezikut kreditor të aprovuara nga bordi i drejtorëve;
  - 7.6. Sigurojë proces gjithëpërfshirës të raportimit të rrezikut kreditor;
  - 7.7. Krijojë një sistem informativ efektiv të menaxhmentit për të siguruar raportim të saktë, me kohë dhe informativ mbi ekspozimet e rrezikut kreditor;
  - 7.8. Sigurojë burime të mjaftueshme dhe personel kompetent për të menaxhuar dhe kontrolluar operacionet e përditshme dhe në mënyrë efektive funksionet e menaxhimit të rrezikut kreditor;
  - 7.9. Kryejë në mënyrë periodike një vlerësim të pavarur të funksionit të lejimit të kredive të bankës.
  - 7.10. Zhvillojë dhe sigurojë procese të përshtatshme, të cilat duhet të aplikohen në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme për të përcaktuar rezervat e duhuara për humbjet nga kreditë;
  - 7.11. Raportoëj periodikisht rezultatet e vlerësimit të rrezikut kreditor dhe proceset e matjes duke përfshirë vlerësimin e rezervave nga HPK.
8. Bankat duhet të kenë një sistem efektiv të kontrollit të brendshëm për vlerësimin dhe matjen e rrezikut kreditor i cili duhet të përfshijë:
  - 8.1. Masat për të qenë në përputhje me ligjet, rregulloret, si dhe politikat dhe procedurat e brendshme;
  - 8.2. Masat për të siguruar saktësinë dhe integritetin e informatave të përdorura dhe të cilat në mënyrë të arsyeshme sigurojnë që rezervat për humbjet nga kreditë të paraqitura në pasqyrat financiare dhe në raportet rregullative të jenë të përgatitura në përputhje me SNRF-të;
  - 8.3. Procese të përcaktuara qartë të matjes dhe vlerësimit të rrezikut të cilat janë të pavarura nga (duke marrë parasysh të dhënat dhe shpjegimet e duhura) funksioni i kredidhënies, dhe që përmbajnë:

- 8.3.1. Aplikimin e vazhdueshëm të sistemit efektiv të klasifikimit të rrezikut kreditor që saktësisht klasifikon karakteristikat e ndryshme të rrezikut kreditor, identifikon ndryshimet në rrezikun kreditor në kohën e duhur dhe lejon veprimet e nevojshme;
- 8.3.2. Procesin efektiv i cili siguron që i gjithë informacioni i arsyeshëm mbështetës dhe relevant, duke përfshirë edhe atë që parashikohet të ndodhë, është marrë në konsiderim në mënyrën e duhur gjatë matjes së HPK. Kjo përfshinë mbajtjen e raporteve të duhura, detajet e rishikimeve të kryera, si dhe identifikimin dhe përshkrimet e roleve dhe përgjegjësiive të personelit të përfshirë;
- 8.3.3. Politikën e vlerësimit që siguron që matja HPK të bëhet jo vetëm në nivel të ekspozimeve individuale të kredive, por gjithashtu kur është e nevojshme dhe e përshtatshme të bëhet edhe në nivel të portofolit kolektiv duke grupuar ekspozimet bazuar në karakteristikat e përbashkëta të identifikuara të rrezikut kreditor;
- 8.3.4. Proces efektiv të validimit (vlefshmërisë) të modelit për të siguruar që vlerësimi i rrezikut kreditor dhe modelet e matjes janë në gjendje të nxjerrin në mënyrë të vazhdueshme vlerësime parashikuese të sakta, të qëndrueshme dhe të paanshme. Ky përfshinë vendosjen e politikave dhe procedurave që përcaktojnë strukturën e llogaridhënies dhe raportimit të procesit, standardet e brendshme për vlerësimin dhe miratimin e ndryshimeve në modelet dhe raportimin e rezultatit të validimit të modelit;
- 8.3.5. Komunikimin dhe koordinimin e qartë ndërmjet stafit që merret me menaxhimin e rrezikut kreditor të bankës, stafit të raportimit financiar, menaxhmentit të lartë, bordit dhe të tjerëve që janë të përfshirë në vlerësimin e rrezikut kreditor dhe procesin e vlerësimit të rrezikut kreditor dhe matjen e HPK duke u bazuar në kornizën e kontabilitetit, siç është e zbatueshme (të evidentuar me politika dhe procedura të shkruara, raporte të menaxhmentit dhe procesverbale);
- 8.3.6. Funksion të auditimit të brendshëm që vlerëson në mënyrë të pavarur efektivitetin e sistemeve dhe proceseve të vlerësimit dhe matjeve të rrezikut kreditor të bankës, duke përfshirë edhe klasifikimin e rrezikut kreditor.

## **Neni 6**

### **Stres Testet**

1. Banka, përmes stres testit do të vlerësojë në mënyrë të vazhdueshme dhe adekuate ekspozimin e saj ndaj rrezikut kreditor, duke pasur parasysh ndryshimet e mundshme në të ardhmen, të faktorëve të rrezikut që ndikojnë në kualitetin e portofolit të kredive dhe në situatën financiare të bankës, pasi ajo ndikon në fitimin neto dhe në treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit.

2. Banka duhet të përcaktojë periudhat e kryerjes së stres testeve, së paku në baza vjetore, si dhe raportimin e rezultateve në strukturat e menaxhmentit të lartë, në përputhje me madhësinë e veprimtarisë, të dhëna për ekspozimet ndaj rrezikut kreditor dhe pjesëmarrjen e tyre në sistemin bankar. BQK-ja mund të kërkojë nga bankat për të kryer stres teste në periudha më të shpeshta dhe/ose sipas skenarëve me supozime shtesë dhe /ose të ndryshme.
3. Stres testet e kryera nga banka duhet të paktën të përfshijnë përdorimin e skenarëve të veçantë dhe/ose të kombinuar, të bazuar në faktorë të tillë siç janë: rënia ekonomike, ndryshimi i shpejtë i kushteve të tregut (rreziku i tregut kushtëzuar nga luhatjet e kursit të këmbimit, normat e interesit, etj.), e cila mund të ketë efekte të pafavorshme në pagesën e rregullt të detyrimit (borxhit), apo skenarët e përkeqësimit të portofolit të kredive, pavarësisht përcaktimit të faktorëve të rrezikut që mund të shërbejnë si një arsye për paraqitjen e një situatë të pafavorshme.
4. Banka duhet të përcaktojë metodologjinë për realizimin e stres testeve, supozimet, si dhe veprimet që mund të ndërmerren duke marrë parasysh rezultatet, ku përfshihen:
  - 4.1. Zbatimi, analiza e skenarëve të stres testeve dhe periudhat e realizimit të tyre;
  - 4.2. Realizimi i stres testeve për skenarë të veçantë, individual dhe skenarë të kombinuar, në kushtet e shfaqjes së njëkohshme të disa skenarëve;
  - 4.3. Dokumentimi dhe rishikimi i rregullt i supozimeve të përdorura për kryerjen e stres testeve;
  - 4.4. Forma dhe periudhat e raportimit të rezultateve të stres testeve në strukturat menaxhuese;
  - 4.5. Veprimet që duhet të ndërmerren nga strukturat e menaxhmentit dhe/apo strukturat e veçanta të caktuara për menaxhimin e rrezikut kreditor, duke u bazuar në rezultatet e stres testeve.

## **Neni 7**

### **Procesi i klasifikimit të rrezikut të kredive dhe grupimi**

1. Banka duhet të ketë një proces të klasifikimit të rrezikut të kredive me anë të të cilit në mënyrë të përshtatshme bëhet grupimi i kredive në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut kreditor.
2. Bankat duhet të kenë procedura gjithëpërfshirëse dhe sisteme të informatave për të monitoruar cilësinë e ekspozimeve kreditore.
3. Procesi i klasifikimit të rrezikut të kredive duhet të përfshijë një funksion të pavarur të rishikimit.
4. Bankat duhet të marrin parasysh një numër kriteresh kur caktojnë klasifikimin e rrezikut të kredive pas njohjes fillestare të një ekspozimi kreditor duke përfshirë, në masën e arsyeshme



llojin e produktit, afatet dhe kushtet, llojin dhe shumën e kolateralit, karakteristikat e huamarrësit dhe gjeografinë ose një kombinim të tyre.

5. Sistemi i klasifikimit të rrezikut të kredive duhet të mbulojë të gjitha ekspozimet kreditore për të lejuar një diferencim/dallim të përshtatshëm të rrezikut kreditor dhe grupimin e ekspozimeve brenda sistemit të klasifikimit të rrezikut të kredive; të pasqyrojë rrezikun e ekspozimeve individuale dhe kur të agregohen/mblidhen të gjitha ekspozimet, të pasqyroj nivelin e rrezikut të portflios së kredive si tërësi.
6. Në përshkrimin e elementeve të sistemit të klasifikimit të rrezikut të kredive, banka duhet të përcaktojë qartë çdo klasë të rrezikut të kredive dhe të caktojë personelin përgjegjës për hartimin, zbatimin, funksionimin dhe performancën e sistemit, si dhe ata që janë përgjegjës për testimin periodik dhe validimin (funksioni i rishikimit të pavarur) e sistemit të klasifikimit.
7. Klasat e rrezikut të kredive duhet të rishikohen sa herë që të merren informata të reja ose kur ndryshojnë pritjet e bankës për rrezikun e kredive. Klasat e caktuara të rrezikut të kredive duhet të rishikohen në mënyrë periodike, së paku një herë në vit, për të siguruar në mënyrë të arsyeshme që këto klasa të jenë të sakta dhe të përditësuara. Klasat e rrezikut të kredive për ekspozimet kreditore të vlerësuara në mënyrë individuale që janë me rrezik më të lartë ose kredi të çvlerësuara duhet të rishikohen më shpesh se një herë në vit.
8. Vlerësimet HPK duhet të përditësohen në kohën e duhur për të pasqyruar ndryshimet në klasat e rrezikut të kredive për secilën prej grupeve të ekspozimeve ose ekspozimeve individuale.
9. Banka duhet të grupojë ekspozimet me karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor në mënyrë që të jetë në gjendje të vlerësojë në hollësi dhe në mënyrë të arsyeshme ndryshimet në rrezikun e kredive dhe kështu të vlerësoj ndikimin në matjen HPK për këto grupe.
10. Metodologjia e bankave për grupimin e ekspozimeve për të vlerësuar rrezikun e kredive (të tilla si: sipas llojit të instrumentit, termave dhe kushteve të produktit, segmentit të industrisë/tregut, vendndodhjes gjeografike) duhet të dokumentohen dhe t'i nënshtrohen rishikimit të duhur dhe miratimit të brendshëm nga menaxhmenti i lartë.
11. Ekspozimet nuk duhet të grupohen në atë mënyrë që rritja e rrezikut kreditor për ekspozime të veçanta të jetë e mbuluar nga performanca e grupit në tërësi.
12. Banka duhet të ketë procese të qëndrueshme për të siguruar grupimin fillestar të duhur të ekspozimeve kreditore. Grupimi i ekspozimeve duhet të rivlerësohet dhe ekspozimet duhet të ri-segmentohen nëse pranohen informata të reja të rëndësishme ose pritjet e institucionit për rrezikun kreditor ndryshojnë duke sugjeruar rregullim të përhershëm. Nëse një bankë nuk është në gjendje të ri-segmentojë ekspozimet në kohën e duhur, duhet të përdoret një rregullim i përkohshëm.

## Neni 8

### Metodologjitë e rezervave për humbjet nga kreditë

1. Banka duhet të miratojë, dokumentojë dhe t'i përmbahet metodologjive të shëndosha që adresojnë politikat, procedurat dhe kontrollet për vlerësimin dhe matjen e rrezikut kreditor në të gjitha ekspozimet kreditore. Matja e rezervave duhet të bazohet në këto metodologji dhe të rezultojë në njohjen e duhur dhe në kohë të humbjeve të pritshme të kredisë në përputhje me SNRF 9.
2. Procesi i vlerësimit dhe matjes së rrezikut kreditor duhet të sigurojë informacionin përkatës për menaxhmentin e lartë në mënyrë që të përdor gjykimin profesional rreth rrezikut kreditor për ekspozimet në bilancin e gjendjes, zërat jashtë-bilancor dhe vlerësimet që lidhen me HPK-të.
3. Banka duhet të zhvillojë dhe të integrojë proceset e përbashkëta që përdoren brenda saj për të përcaktuar se kur dhe në cilat kushte kredia duhet të lejohet; të monitorojë rrezikun kreditor dhe të matë rezervat për humbjet nga kreditë për qëllime kontabël dhe për qëllimet e mjaftueshmërisë së kapitalit.
4. Metodologjitë e rezervave të bankës duhet të përcaktojnë qartë kriteret kyçe në lidhje me vlerësimin dhe matjen e HPK. Informacioni dhe supozimet e përdorura për vlerësimet HPK duhet të rishikohen dhe përditësohen ashtu siç kërkohen me SNRF.
5. Banka duhet të ketë procese dhe sisteme adekuate për të identifikuar, matur, vlerësuar, monitoruar, raportuar dhe zbutur nivelin e rrezikut kreditor.
6. Metodologjitë e shëndosha për vlerësimin e rrezikut kreditor dhe matjen e nivelit të rezervave duhet të përfshijnë në veçanti:
  - 6.1. Procese të qëndrueshme që janë projektuar për të pajisur bankën me aftësinë për të njohur nivelin, natyrën dhe shkaktarët e rrezikut kreditor pas njohjes fillestare të ekspozimit me qëllim të sigurimit që ndryshimet pasuese në rrezikun kreditor të mund të identifikohen dhe të përcaktohen;
  - 6.2. Kriteret që marrin parasysh ndikimin e informacionit të parashikuar, duke përfshirë faktorët makroekonomikë;
  - 6.3. Për ekspozimet e vlerësuara në mënyrë grupore, një përshkrim të bazës për krijimin e grupeve të portofoleve të ekspozimeve me karakteristika të përbashkëta të rrezikut kreditor;
  - 6.4. Identifikimin dhe dokumentimin e metodave të vlerësimit dhe matjeve të HPK (të tilla si metoda e normës së humbjes, metodën e probabilitetit të dështimit (PD) / humbjes së dhënë të dështimit (LGD) ose ndonjë metodë tjetër që do të aplikohet për secilën ekspozim ose portofol;

- 6.5. Dokumentimin e arsyeshmërisë së metodës së zgjedhur, veçanërisht nëse janë përdorur metoda të ndryshme të matjes HPK për portofolio dhe lloje të ndryshme të ekspozimeve individuale. Banka duhet të jetë në gjendje që të ju jap sqarimet e nevojshme mbikëqyrësve të BQK-së, arsyetimin për çdo ndryshim në metodën e matjes, si dhe ndikimet sasiore të këtyre ndryshimeve;
- 6.6. Dokumentimin e burimeve, të dhënave dhe supozimet e përdorura në procesin e vlerësimit të rezervave për humbjet nga kreditë (siç janë normat e humbjeve historike, vlerësimet e PD/LGD dhe parashikimet ekonomike), si përcaktohet jetëgjatësia (kohëzgjatja) e një ekspozimi ose portofoli (duke përfshirë atë se si janë konsideruar parapagimet dhe dështimet, periudha kohore mbi të cilën vlerësohet ecuria historike e humbjes dhe çdo rregullim i nevojshëm për vlerësimin e HPK në përputhje me SNRF 9;
- 6.7. Përfshirjen e një procesi për vlerësimin e përshtatshmërisë së burimeve (inputeve) dhe supozimeve të rëndësishme në metodën e vlerësimit dhe matjes së zgjedhur të HPK;
- 6.8. Identifikimin e situatave që në përgjithësi do të çonin në ndryshime të përshtatshme në metodat e matjes së HPK, në inputet ose supozimet nga periudha në periudhë;
- 6.9. Konsiderimin e faktorëve të rëndësishëm të brendshëm dhe të jashtëm që mund të ndikojnë në vlerësimet HPK, të tilla si standardet e aplikuara të lejimit fillesatr të një ekspozimi kreditor dhe ndryshimet në industri, faktorët gjeografikë, ekonomikë dhe politikë;
- 6.10. Mënyrën e përcaktimit të HPK (që mund të jenë normat e humbjeve historike ose analizat e migrimit si pikënisje, të përshtatura për informacionin mbi kushtet aktuale dhe të pritshme). Një bankë duhet të ketë këndvështrim të paanshëm rreth pasigurisë dhe rreziqeve në aktivitetet e saj kredidhënëse gjatë vlerësimit të HPK;
- 6.11. Identifikimin e faktorëve që merren parasysh gjatë vendosjes së periudhave të përshtatshme historike mbi të cilat do të vlerësohet përvoja historike e humbjes;
- 6.12. Përcaktimin e shkallës në të cilën vlera e kolateralit dhe zbutësit e tjerë të rrezikut kreditor ndikojnë në HPK;
- 6.13. Përshkrimin e politikave dhe procedurave të bankës për shlyerjet dhe kthimet;
- 6.14. Kërkesën që analizat, vlerësimet, rishikimet dhe detyrat/proceset e tjera që janë inpute ose rezultate nga vlerësimi i rrezikut kreditor dhe procesi i matjes të kryhen nga një personel kompetent dhe i trajnuar mirë dhe të validohen nga personeli i pavarur nga aktivitetet kreditore të bankës;
- 6.15. Dokumentimin e metodave të përdorura për të validuar matjen HPK (testet prapavajtëse);

- 6.16. Sigurimin që vlerësimet e HPK të inkorporojnë në mënyrë të përshtatshme informacionin e ardhshëm, duke përfshirë faktorët makroekonomikë, që nuk janë përfshirë ende në rezervat e matura në bazë të ekspozimit individual;
- 6.17. Procese për të vlerësuar përshtatshmërinë e rezervave për humbjet nga kreditë të ndërtuara në përputhje me SNRF, duke përfshirë rishikimin e rregullt vjetor të modeleve HPK.
7. Procesi i identifikimit të rrezikut kreditor duhet të sigurojë që faktorët që ndikojnë në ndryshimet në rrezikun kreditor dhe vlerësimet e HPK-të të identifikohen në mënyrën e duhur dhe në bazë të rregullt. Gjithashtu, konsiderimi i rrezikut të vetëvetishëm kreditor nga produktet dhe aktivitetet e reja duhet të jetë një pjesë thelbësore e procesit të identifikimit të rrezikut, si dhe vlerësimit dhe matjes së HPK.
8. Menaxhmenti i lartë duhet të marrë parasysh faktet dhe rrethanat e rëndësishme, duke përfshirë edhe informatat e parashikuara, që mund të qonin në ndryshim të HPK-të krahasuar me përvojën historike dhe që mund të ndikojnë në rrezikun kreditor dhe arkëtimin e plotë të rrjedhave monetare.
9. Lidhur me faktorët që lidhen me karakterin, kapacitetin dhe kapitalin e huamarrësve, kushtet e dhënies së kredisë dhe vlerat e asetëve të lëna si kolateral së bashku me zbutësit e tjerë të rrezikut kreditor që mund të ndikojnë në arkëtimin e plotë të rrjedhave të parasë, banka (varësisht nga lloji i ekspozimit) mund të konsiderojë:
- 9.1. Politikat dhe procedurat e kreditimit, duke përfshirë standardet e lejimit dhe kushtet e kreditimit, që kanë qenë në fuqi me rastin e njohjes fillestare të kredisë së huamarrësit dhe nëse kredia ishte lejuar si përjashtim me këtë politikë;
- 9.2. Burimet e të ardhurave në dispozicion të huamarrësit për të përmbushur planin e pagesave;
- 9.3. Aftësinë e huamarrësit për të gjeneruar një rrjedhë të mjaftueshme të parasë për jetëgjatësinë e instrumentit financiar;
- 9.4. Nivelin e përgjithshëm të borxhit të huamarrësit dhe pritshmëritë e ndryshimeve të këtij niveli;
- 9.5. Pasuritë e pa lëna barrë që huamarrësi mund t'i lë si kolateral në treg ose në bankë për të mbledhur fonde dhe pritjet e ndryshimeve në vlerën e atyre pasurive;
- 9.6. Ngjarjet e mundshme të njëpasnjëshme dhe sjelljet e përsëritura që mund të ndikojnë në aftësinë e huamarrësit për të përmbushur detyrimet kontraktuale; dhe
- 9.7. Vlerësimet me kohë të vlerës së kolateralit dhe konsiderimi i faktorëve që mund të ndikojnë në vlerën e ardhshme të kolateralit.

10. Faktorët që lidhen me modelin e biznesit të bankës dhe me kushtet aktuale dhe të parashikuara makroekonomike, që kanë mundësi të ndikojnë në aftësinë e bankës për të kthyer shumat në vonesë, duke konsideruar:
  - 10.1. Konkurrencën, kërkesat ligjore dhe rregullative;
  - 10.2. Trendet e shumave të përgjithshme të kredive të bankës;
  - 10.3. Profili i përgjithshëm i rrezikut kreditor të ekspozimeve të bankës dhe pritshmëritë e ndryshimeve të tyre;
  - 10.4. Koncentrimin e kredive ndaj huamarrësve ose sipas llojit të produktit, sektorit apo tregut;
  - 10.5. Pritjet për mbledhjen, shlyerjet dhe praktikatat e kthimit;
  - 10.6. Cilësinë e sistemit të rishikimit të rrezikut kreditor dhe shkallën e mbikëqyrjes nga menaxhmenti i lartë dhe bordi i bankës;
  - 10.7. Faktorët tjerë që mund të ndikojnë në HPK si, por pa u kufizuar në, pritjet e ndryshimeve në normën e papunësisë, produktin e brendshëm bruto, normave bazë të interesit, inflacionit, kushteve të likuiditetit ose teknologjisë; dhe
  - 10.8. Nxitjen ose gatishmërinë e huamarrësve për të përmbushur detyrimet e tyre.
11. Metodologjitë e shëndosha të rrezikut kreditor duhet të marrin në konsideratë skenarë të ndryshëm të mundshëm dhe nuk duhet të mbështeten vetëm në qasje subjektive, të njëanshme ose tepër optimiste. Banka duhet të zhvillojë dhe dokumentojë proceset e tyre për të gjeneruar skenarë të rëndësishëm që do të përdoren në vlerësimin e HPK. Në veçanti:
  - 11.1. Banka duhet të demonstrojë dhe dokumentojë se si matjet HPK do të ndryshonin me ndryshimet në skenarë, duke përfshirë ndryshimet në kushtet e rëndësishme të jashtme me efekt të mundshëm në matjen e HPK ose në komponentët e llogaritjes së HPK (të tilla si probabiliteti i dështimit dhe humbjet e dhëna nga dështimi);
  - 11.2. Banka duhet të ketë një proces të dokumentuar për përcaktimin e horizontit kohor të skenarëve dhe, nëse është e përshtatshme, si vlerësohet HPK për ekspozimet, jetëgjatësia e të cilave tejkalon periudhën e mbuluar nga parashikimet ekonomike të përdorura;
  - 11.3. Skenarët mund të zhvillohen për brenda ose nga pala e jashtme e kontraktuar;
  - 11.4. Testimet prapavajtëse duhet të kryhen me qëllim të sigurimit që faktorët më të rëndësishëm ekonomik që ndikojnë në rrezikun kreditor janë konsideruar dhe përfshirë në vlerësimet HPK.
12. Banka duhet të marrë në konsideratë të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që ka lidhje me produktin, huamarrësin, modelin e biznesit ose mjedisin ekonomik dhe rregullator gjatë zhvillimit të matjeve HPK.

13. Menaxhmenti i lartë duhet të jetë në gjendje të demonstrojë se i kupton dhe i merr parasysh në mënyrën e duhur rreziqet e vetëvetishme kur përcakton çmimet e ekspozimeve kreditore.
14. Politikat kontabël të bankës duhet të adresojnë dhe metodologjia e rezervave të bankës duhet të përfshijë kriteret për ristrukturimin / modifikimin e ekspozimeve kreditore dhe trajtimin e ekspozimeve kreditore të çvlerësuara të blera apo të krijuara ashtu sikurse janë të përcaktuara në SNRF dhe Rregulloren për Ekspozimet Jo-performuese dhe Ristrukturimet.

## **Neni 9**

### **Përdorimi i rregullimeve të përkohshme në rezerva**

1. Bankat mund të përdorin rregullimet e përkohshme të rezervave për të llogaritur rrethanat kur bëhet e qartë se faktorët e rrezikut ekzistues ose të pritur nuk janë marrë në konsideratë në procesin e klasifikimit të rrezikut kreditor dhe të modelimit.
2. Bankat duhet të përdorin rregullime të tilla vetëm si një zgjidhje e përkohshme.
3. Rregullimet e përkohshme duhet të jenë në përputhje të drejtpërdrejtë me parashikimet e ardhshme, të mbështetura me dokumentacion të përshtatshëm dhe subjekt i proceseve të duhura të qeverisjes.

## **Neni 10**

### **Rezerva për humbjet kreditore në një shumë të barabartë me Humbjet e Pritura Kreditore 12 mujore**

1. Një bankë duhet të matë Humbjet e Pritura Kreditore (HPK) për të gjitha ekspozimet kreditore. Nëse, në datën e raportimit, rreziku kreditor për një instrument financiar nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, një bankë matë rezervat e humbjes për atë instrument financiar në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme dymbëdhjetë (12) mujore të kredisë siç është përcaktuar nga SNRF për çvlerësimin e instrumenteve financiare.
2. Banka duhet të miratojë një qasje aktive për vlerësimin dhe matjen e HPK dymbëdhjetë (12) mujore që mundëson që ndryshimet në rrezikun kreditor të identifikohen në kohën e duhur dhe në këtë mënyrë njohjen me kohë të këtyre ndryshimeve në HPK.
3. Banka duhet të përcaktojë dështimin në përputhje me atë të përdorur për menaxhimin e brendshëm të rrezikut kreditor siç kërkohet nga SNRF 9 dhe gjithashtu duhet të marrë parasysh:
  - 3.1. kriterin cilësor me të cilin "banka konsideron se huamarrësi nuk ka gjasa të paguajë në tërësi detyrimet kreditore ndaj bankës"; dhe

- 3.2. treguesin objektiv ku "huamarrësi është në vonesë më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë për çdo detyrim material kreditor në bankë", ekuivalent me supozimin e kundërshtueshëm në SNRF 9.
4. Një ngjarje dështimi do të konsiderohet se ka ndodhur në lidhje me një huamarrës të caktuar kur njëri ose dy nga kriteret e paragrafit 3 nënparagrafi 3.1 dhe 3.2 të këtij neni është ose janë plotësuar. Një bankë duhet të identifikojë dështimin në përputhje me 'pamundësinë për të paguar' kriterin e debitorit, përpara se ekspozimi të bëhet delikuent me kriterin nëntëdhjetë (90) ditë të vonesës.
5. Për qëllim të paragrafit 4 të këtij neni, elementet që duhet të merren si tregues të pamundësisë për të paguar duhet të përfshijnë:
- 5.1. Banka vendos obligimin kreditor në statusin jo-akruar;
- 5.2. Banka njih një rregullim specifik kreditor që rezulton nga një rënie domethënëse e perceptuar e cilësisë kreditore që vjen pas marrjes së ekspozimit nga banka;
- 5.3. Banka shet detyrimin kreditor me një humbje ekonomike materiale kreditore;
- 5.4. Banka miraton një ristrukturim të vështirë të detyrimit kreditor, kur kjo ka gjasa të rezultojë në një detyrim financiar të zvogëluar të shkaktuar nga falja materiale, ose shtyrja e principalit, interesit ose, kur është e përshtatshme, tarifave. Kjo përfshinë, në rastin e ekspozimeve të kapitalit të vlerësuar në bazë të një metode PD/HDHD ("PD /LGD"), ristrukturimin e vetë kapitalit;
- 5.5. Banka ka filluar procesin e likuidimit të huamarrësit ose ka një urdhër të ngjashëm në lidhje me obligimin e huasë së kredimarrësit ndaj bankës, bankës mëmë ose ndonjë subjekti të varur të saj;
- 5.6. Huamarrësi ka kërkuar ose është vendosur në likuidim ose mbrojtje të ngjashme, nëse kjo do të shmangte ose do të vononte shlyerjen e një detyrimi kreditor ndaj bankës, bankës mëmë ose ndonjë subjekti i varur i saj.
6. Kur një bankë lejon ekspozime me rrezik kreditor të lartë dhe rezervat e tyre fillimisht maten me HPK dymbëdhjetë (12) mujore, banka duhet të monitorojë këto ekspozime nga afër për rritjen domethënëse të rrezikut kreditor për të siguruar lëvizjen në kohë të ekspozimit të matjes së HPK gjatë gjithë jetës, në mënyrë që të marrin në konsideratë që ekspozimet me rrezik të lartë ka mundësi të shfaqin luhatshmëri më të madhe dhe të përjetojnë një rritje më të shpejtë të rrezikut kreditor.
7. Bankat duhet të përcaktojnë një shumë të barabartë me matjen dymbëdhjetë (12) mujore të HPK në baza individuale ose kolektive.
8. Një bankë duhet të rregullojë vlerësimin HPK dymbëdhjetë (12) mujor, edhe nëse një rritje në rrezikun kreditor nuk gjykohet të jetë i konsiderueshëm, në mënyrë që të pasqyrojë në mënyrë adekuate ndryshimet në rrezikun kreditor që kanë ndodhur.

9. Një bankë nuk duhet të grupojë ekspozimet e huadhënies në mënyrë të tillë që të vështirësojë identifikimin e rritjeve të konsiderueshme të rrezikut kreditor në kohën e duhur.

## **Neni 11**

### **Vlerësimi i rritjeve domethënëse në rrezikun kreditor**

1. Banka duhet të ketë sisteme dhe kontrolla të shëndosha qeverisëse në përputhje me këtë Rregullore, në mënyrë që të shqyrtojë nëse një ekspozim ka pësuar një rritje domethënëse të rrezikut kreditor dhe matjen e HPK-së dymbëdhjetë (12) mujore të kërkuar dhe HPK për jetëgjatësinë.
2. Bankat duhet të kenë procese që u mundësojnë të përcaktojnë me kohë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse nëse ka pasur një rritje domethënëse në rrezikun kreditor pas njohjes fillestare të ekspozimit kreditor në mënyrë që një ekspozim individual ose një grup ekspozimesh me karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor, transferohet në matjen e HPK për jetëgjatësi sa më shpejtë që rreziku kreditor është rritur në mënyrë domethënëse, në pajtueshmëri me kërkesat e kontabilitetit për çvlerësim sipas SNRF 9.
3. Për qëllim të njohjes së rezervave me kohë në përputhje me kërkesat e SNRF 9, bankat duhet:
  - 3.1. Të grumbullojnë të dhënat dhe parashikimet e së ardhmes për faktorët kryesorë të rrezikut kreditor në portfoliot e tyre;
  - 3.2. Të jenë në gjendje të masin rrezikun kreditor për çdo ekspozim ose për portofolio bazuar në këto të dhëna dhe parashikime.
4. Bankat duhet të njohin humbjet e pritshme kreditore për jetëgjatësi, para se një instrument financiar të kalojë në vonesë. Analizat e bankës duhet të marrin parasysh faktin që përcaktuesit e humbjeve kreditore shumë shpesh fillojnë të përkeqësohen një kohë të konsiderueshme (muaj ose, në disa raste vite) përpara se ndonjë dëshmi objektive e përkeqësimit (delikuecës) të shfaqet në ekspozimet kreditore të prekura.
5. Për të përmbushur kërkesat e paragrafit 4 të këtij neni, banka duhet të marrë në konsideratë lidhjet midis faktorëve makroekonomikë dhe attributeve të huamarrësit në nivelin e rrezikut kreditor në një portofolio bazuar në informacione mbështetëse dhe të arsyeshme.
6. Bankat duhet të kenë një politikë të qartë duke përfshirë kriteret e zhvilluara mirë për atë që përbënë një rritje "domethënëse" në rrezikun kreditor për lloje të ndryshme të ekspozimeve të huadhënies.
7. Në zhvillimin e qasjes së tyre për të përcaktuar një rritje domethënëse të rrezikut kreditor, bankat e konsiderojnë secilën nga gjashtëmbëdhjetë (16) klasat e treguesve siç përcaktohet në SNRF 9 dhe, përveç kësaj, të shqyrtojë nëse ka informacione shtesë që duhet të merren parasysh.
8. Në vlerësimin e një rritje domethënëse të rrezikut kreditor, banka duhet të marrë në konsideratë në veçanti listën e treguesve:



- 8.4. Vendimin nga menaxhmenti i lartë i bankës të tillë që, nëse një ekspozim ekzistues i huadhënies është lejuar në datën e raportimit, elementi i çmimit të ekspozimit të huadhënies që pasqyron rrezikun kreditor të ekspozimit do të ishte më i lartë se sa kur është lejuar huaja në të vërtetë, për shkak të rritjes së rrezikut kreditor të një huamarrësi të veçantë ose klasës së huamarrësve që nga fillimi;
  - 8.5. Vendimin nga menaxhmentit të lartë i bankës për të forcuar kërkesat e kolateralit dhe/ose kërkesat e marrëveshjes për ekspozimet e reja të huadhënies që janë të ngjashme me ekspozimet e huadhënies që janë lejuar, për shkak të ndryshimeve në rrezikun kreditor të atyre ekspozimeve që nga njohja fillestare;
  - 8.6. Një ulje e vlerësimit (ang. “rating”) të një huamarrësi nga një agjenci e njohur e vlerësimit kreditor, ose brenda sistemit të brendshëm të klasifikimit kreditor të bankës;
  - 8.7. Për ekspozimet kreditore performuese që i nënshtrohen monitorimit dhe rishikimit individual, një vlerësim i brendshëm kreditor / tregues i cilësisë kreditore që është më i dobët se kur është bërë njohja fillestare;
  - 8.8. Përkeqësimi i përcaktuesve të rëndësishëm të rrezikut kreditor (rrjedhat e ardhshme –të parasë) për një huamarrës individual ose grup huamarrësish; dhe
  - 8.9. Ristrukturimi për shkak të vështirësive financiare.
9. Gjatë vlerësimit nëse ka pasur rritje domethënëse të rrezikut kreditor për një ekspozim kreditor, banka duhet gjithashtu të marrë parasysh faktorët e mëposhtëm që lidhen me mjedisin në të cilin vepron banka ose huamarrësi:
    - 9.1. Përkeqësimi i perspektivës makroekonomike që lidhet me një huamarrës të caktuar ose me një grup huamarrësish;
    - 9.2. Përkeqësimi i ngjarjeve të ardhshme për sektorin ose industrinë në kuadër të të cilave operon huamarrësi.
  10. Bankat duhet të rishikojnë me një vëmendje më të madhe cilësinë e qasjes së tyre për të vlerësuar nëse rreziku kreditor është rritur në mënyrë domethënëse. Menaxhmenti i lartë duhet të shqyrtojë nëse ka faktorë shtesë që duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të rritjeve domethënëse në rrezikun kreditor që do të përmirësonte cilësinë e qasjes së tyre.
  11. Bankat duhet të sigurojnë që modifikimet ose rinegociimet të mos fshehin rritjen e rrezikut kreditor dhe në këtë mënyrë të shkaktojnë nënvlerësimin e HPK dhe të vonojnë transferimin në HPK të jetëgjatësisë për huamarrësit, rreziku kreditor i të cilit është përkeqësuar në mënyrë domethënëse ose rezulton në mënyrë jo adekuate në një lëvizje nga matja e HPK të jetëgjatësisë përsëri në matjen dymbëdhjetë (12) mujore të HPK.

## **Neni 12**

### **Përdorimi i mjeteve praktike**

1. SNRF 9 adreson mjetet praktike si në vijim: grupin e informacionit që banka duhet të marrë parasysh në matjen e HPK; përjashtimin për ekspozimet me “rrezik të ulët kreditor” dhe supozimin e kundërshtueshëm të vonesës tridhjetë (30) ditore.
2. Bankat duhet të përdorin në mënyrë të kufizuar mjetet praktike të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni. Bankat duhet të marrin në konsideratë nevojën për të bërë rregullime kur përdorin mjetet praktike për të shmangur çdo paragjykim që rezulton, pasi që duhet të marrin parasysh se objektivi i SNRF 9 është të vlerësojë humbjet e pritshme kreditore për të pasqyruar një shumë të paanshme dhe të peshuar me probabilitet.
3. Kur një bankë përdor mjete të tilla praktike, arsyetimet për përdorimin e mjeteve praktike duhet të dokumentohen qartë nga banka.

## **Neni 13**

### **Adekuatshmëria e rezervës**

1. Shuma e përgjithshme e rezervave të bankës, pavarësisht nëse përbërësit e rezervës përcaktohen në baza kolektive ose individuale, duhet të jetë adekuate dhe në përputhje me objektivat e kornizës së SNRF 9.
2. Bankat duhet të zbatojnë metodologji të shëndosha të rrezikut kreditor me objektivin që bilanci i përgjithshëm i rezervës për HPK të jetë i zhvilluar në përputhje me SNRF 9 dhe që reflekton në mënyrë adekuate HPK.
3. Bankat duhet të marrin parasysh informacionin që shkon përtej të dhënave historike dhe aktuale për të marrë në konsideratë informacionin përkatës parashikues duke përfshirë faktorët makroekonomikë që janë të rëndësishëm për ekspozimin që vlerësohet në përputhje me kornizën e SNRF-së.
4. Bankat mund të përdorin qasje vlerësimi individuale ose grupore kur përfshijnë informacionin e parashikuar në vlerësimin e HPK, pavarësisht se qasja duhet të jetë në përputhje me kërkesat përkatëse të kontabilitetit.

## **Neni 14**

### **Validimi i modelit të HPK**

1. Banka duhet të ketë politika dhe procedura për të vërtetuar në mënyrë të përshtatshme modelet e përdorura për të vlerësuar dhe matur humbjet e pritura kreditore.
2. Banka duhet të ketë politika dhe procedura të qëndrueshme për të vërtetuar saktësinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve dhe proceseve të vlerësimit të modelit të saj dhe vlerësimin e

të gjitha komponentëve të rrezikut në fillim të përdorimit të modelit dhe në mënyrë të vazhdueshme.

3. Bankat duhet të kryejnë validimin e modelit kur modelet e HPK fillimisht zhvillohen dhe kur bëhen ndryshime të rëndësishme në modele.
4. Banka duhet të rishikojë çdo vit modelet e saj për HPK.
5. Një kornizë e validimit të modelit të shëndoshë duhet të përfshijë, por jo të kufizohet, në elementet e mëposhtme:
  - 5.1. Rolet dhe përgjegjësitë e qarta për validimin e modelit me pavarësi dhe kompetencë adekuate;
  - 5.2. Fushëveprimin e përshtatshëm të validimit të modelit dhe metodologjisë që përfshinë një proces sistematik të vlerësimit të qëndrueshmërisë, konsistencës dhe saktësisë së modelit, si dhe rëndësinë e tij të vazhdueshme ndaj portofolios bazë;
  - 5.3. Dokumentacion gjithëpërfshirës të kornizës dhe procesit të validimit të modelit;
  - 5.4. Një rishikim i procesit të validimit të modelit nga palët e pavarura të specializuara (palët e brendshme ose të jashtme) për të vlerësuar efektivitetin e përgjithshëm të procesit të validimit të modelit dhe pavarësinë e procesit të validimit të modelit nga procesi i zhvillimit;
  - 5.5. Gjetjet e rishikimit duhet të raportohen në mënyrë të shpejtë dhe me kohë në nivelin e duhur hierarkik të bankës.

## **Neni 15**

### **Proceset, sistemet, instrumentet dhe të dhënat**

1. Bankat duhet të kenë mjetet e nevojshme për të siguruar një vlerësim të qëndrueshëm dhe njohjen me kohë të HPK.
2. Përdorimi i gjykimit kreditor sipas përvojës së kaluar nga banka duhet të dokumentohet në metodologjinë e rrezikut kreditor të bankës dhe t'i nënshtrohet mbikëqyrjes adekuate.
3. Bankat duhet të jenë në gjendje të vërtetojnë se informacioni parashikues i përfshirë në procesin e vlerësimit të HPK ka lidhje me faktorët nxitës të rrezikut kreditor për ekspozime ose portofolio të caktuara.
4. Parashikimet makroekonomike dhe informacionet e tjera të rëndësishme duhet të aplikohen vazhdimisht në portfoliot ku faktorët nxitës të rrezikut kreditor të portofoliove ndikohen nga këto parashikime / supozime në të njëjtën mënyrë. Për më tepër, kur zhvillohen vlerësimet e HPK, bankat duhet të zbatojnë gjykimin e tyre kreditor sipas përvojës për të marrë parasysh pikën e tyre në ciklin kreditor, që mund të ndryshojnë në të gjitha juridiksionet në të cilat ato kanë ekspozime kreditore.

5. Banka duhet të tregojë kujdes për përcaktimin e nivelit të rezervave të HPK që duhet të njihen për qëllime kontabël për të siguruar që vlerësimet e bëra janë të përshtatshme (në përputhje me neutralitetin dhe as të nënvlerësuara apo të mbivlerësuara).
6. Banka duhet të ketë një vlerësim të shëndoshë të rrezikut kreditor dhe procesit të matjes, që siguron një bazë të fortë për sistemet, instrumentet dhe të dhënat e zakonshme për të vlerësuar rrezikun kreditor dhe për të llogaritur humbjet e pritshme kreditore.
7. Praktikrat e rrezikut kreditor nuk duhet të jenë statike dhe duhet të rishikohen në mënyrë periodike për të siguruar që të dhënat përkatëse të disponueshme në të gjithë bankën janë përmbledhur dhe sistemet janë përditësuar atëherë kur praktikrat e kreditimit dhe të afarizmit ndryshojnë ose evoluojnë me kalimin e kohës.

## **Neni 16** **Shlyerjet**

1. Bankat duhet të zhvillojnë politika që përshkruajnë bazat në të cilat ekspozimet kreditore konsiderohen si ekspozime jo-performuese në përputhje me Rregulloren për Ekspozimet Jo performuese dhe Ristrukturimet si dhe politikrat dhe procedurat për shlyerjet.
2. Kur një kredi klasifikohet si jo-performuese dhe banka ka ndarë rezerva për humbje nga kreditë prej njëqindpërqind (100%), duhet ta shlyejë atë nga bilanci me kriteret dhe kushtet e mëposhtme:
  - 2.1. Ekspozimet kreditore që nuk mbulohen me kolateral, qoftë në formë pengu ose në formë hipoteke, të klasifikuara si ekspozim jo-performues, shlyhen nga bilanci brenda tetëmbdhjetë (18) muajve nga periudha kur ato klasifikohen në këtë kategori;
  - 2.2. Ekspozimet kreditore që mbulohen nga kolaterali në formë pengu të klasifikuara si jo-performuese duhet të shlyhen nga bilanci i gjendjes brenda tridhjetëegjastë (36) muajve nga periudha kur ato janë klasifikuar si joperformuese;
  - 2.3. Ekspozimet kreditore që mbulohen me kolateral në formën e hipotekave të klasifikuara si ekspozime jo-performuese duhet të shlyhen nga bilanci i gjendjes brenda gjashtëdhjetë (60) muajve nga periudha kur ato klasifikohen si joperformuese.
  - 2.4. Ekspozimet kreditore që mbulohen nga kolaterali i kombinuar, në formën e pengut dhe në formën e hipotekës, në rastet kur hipoteka mbulon më shumë se pesëdhjetë përqind (50%) të ekspozimit në kohën e aprovimit, më pas për qëllimin e ripagimit, ekspozimet kreditore duhet të trajtohen sipas paragrafit 2.3 të këtij neni;
  - 2.5. Lista e kredive të ripagueshme në përputhje me kërkesat e këtij neni duhet të raportohet në takimet e rregullta me Bordin e Drejtorëve të Bankës. Ndërsa shlyerjet e ekspozimeve për personat që ndërlidhen me bankën duhet të bëhen vetëm me aprovimin paraprak nga Bordi i Drejtorëve të bankës.

## **Neni 17**

### **Njohja e kolateralit**

1. Në llogaritjen e shumës së çvlerësimit të asetëve të bilancit të gjendjes dhe ekspozimeve jashtë bilancore, banka duhet të marrë parasysh rrjedhën e parasë që rrjedh nga kolaterali (instrumentet) që siguron ekspozimin në përputhje me SNRF 9.
2. Banka duhet të përcaktojë instrumentet e kolateralit që duhet të merren parasysh, në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, mënyrën e përcaktimit të vlerës së tyre dhe periudhën e pritshme që do të arkëtohen.
3. Kolaterali i pranueshëm për qëllimet e këtij neni përkufizohet si:

#### **3.1. Kolaterali financiar:**

- 3.1.1. Kolaterali i parasë së gatshme ose bilancet e llogarive depozituese të mbledhura plotësisht në posedim të bankave dhe subjekt i marrëveshjes së kolateralit në formë të pengut të ekzekutuar në mënyrë të vlefshme
- 3.1.2. Çdo marxhinë e depozitës në formë të parasë së gatshme e mbajtur në bankë për të siguruar një letër kredi ose garanci;
- 3.1.3. Letrat me vlerë të emetuara ose të garantuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës në atë masë që vlera e tregut e këtyre letrave me vlerë është së paku njëqind për qind (100%) e ekspozimit, me kusht që letrat me vlerë të jenë në posedim të bankës dhe subjekt i një marrëveshje kolaterali në formë pengut të ekzekutuar në mënyrë të vlefshme dhe që rishikohen rregullisht;
- 3.1.4. Letrat me vlerë të emetuara ose të garantuara nga vendet e vlerësuar nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit, të cilat janë të barabarta me vlerësimet S&P "A" ose më të mirë ose të lëshuara nga Bankat e tyre Qendrore në masën që vlera e tregut e këtyre letrave me vlerë është të paktën njëqind për qind (100%) e ekspozimit, me kusht që këto të jenë në posedim të bankës dhe i nënshtrohen një marrëveshjeje të kolateralit në formë të pengut të ekzekutuar në mënyrë të vlefshme dhe që rivlerësohen rregullisht;
- 3.1.5. Letrat me vlerë të tregtueshme të emetuara nga institucionet financiare të klasifikuara nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit, të cilat janë të barabarta me vlerësimet S & P "A" ose më të mirë (aksionet ose obligacionet që janë të listuara dhe tregtuar në mënyrë aktive në një bursë të organizuar për të cilën çmimet e tregut mund të merren lehtësisht) në mënyrë që vlera e tregut e këtyre letrave me vlerë është të paktën njëqind e njëzet e pesë për qind (125%) të ekspozimit, me kusht që këto letra me vlerë të jenë në posedim të bankës, në varësi të një marrëveshjeje të kolateralit në formë të pengut të ekzekutuar në mënyrë të vlefshme dhe që rivlerësohen rregullisht;

3.1.6. Një garanci e pakushtëzuar nga një institucion tjetër financiar që është vlerësuar nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit, të cilat janë të barabarta me S & P ratings "A" ose më mirë nga një agjenci e njohur ndërkombëtare dhe me reputacion.

### **3.2. Instrumentet e përshtatshme të kolateralit në formë të pasurive të paluajtshme**

- 3.2.1. Një bankë duhet të marrë parasysh instrumentet e përshtatshme të kolateralit në formë të pasurive të paluajtshme në vlerësimet e HPK nëse ka në dispozicion të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga i cili është e qartë se pasuria e paluajtshme përkatëse përfaqëson një sistem efikas dhe burim i duhur sekondar i mbledhjes. Një instrument i kolateralit në formë të pasurive të paluajtshme do të konsiderohet se ka këto karakteristika nëse banka është pajisur me dëshmi se ekziston një treg që lejon një likuidim të shpejtë dhe ekonomikisht efikas (me një çmim adekuat) të instrumentit të kolateralit;
- 3.2.2. Gjatë vlerësimit të rrjedhave të ardhshme të parasë bazuar në arkëtimet nga pasuria e paluajtshme, banka duhet të zbatojë faktorët adekuat të çvlerësimit për vlerën e tregut dhe në periudhën përkatëse të arkëtimit të vlerësuar nga banka. Faktorët e çvlerësimit dhe periudha e arkëtimit duhet të marrin parasysh praktikatat e bankave dhe përvojën e kaluar në mbledhjen e instrumenteve adekuate të kolateralit, mjedisit ekonomik dhe ligjor në të cilin vepron banka dhe karakteristikat përkatëse të instrumenteve të kolateralit. Gjatë përcaktimit të nivelit të faktorit të çvlerësimit dhe kohëzgjatjes së periudhës së arkëtimit, banka duhet të marrë parasysh faktin se llojet e ndryshme të instrumenteve të kolateralit pasqyrojnë nivele të ndryshme rrezikut;
- 3.2.3. Bankat duhet, të paktën një herë në vit, të rishikojnë vlefshmërinë e supozimeve për periudhat e grumbullimit të vendosura fillimisht dhe t'i përshtatin ato, kur është e nevojshme;
- 3.2.4. Banka mund të zvogëlojë periudhën e arkëtimit çdo tremujor në përputhje me kohën e kaluar vetëm pasi janë marrë veprime për të thirrur një instrument të kolateralit, nëse vlerëson se arkëtimi kryhet në përputhje me periudhën e caktuar fillimisht. Reduktimi i tillë mund të bëhet vetëm në rastet kur banka mund të dëshmojë sigurinë e rrjedhës së parasë me dokumentacionin adekuat dhe ku është e mundur të matet në mënyrë të besueshme periudha e shlyerjes përfundimtare dhe shuma e përgjithshme e rrjedhës së parasë në bankë mbi këtë bazë;
- 3.2.5. Kur vlerësohet rrjedha e parasë dhe pas përcaktimit të vlerës aktuale në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, banka duhet të marrë parasysh atë pjesë të vlerës së instrumentit të kolateralit në një formë të pasurisë së paluajtshme, që mbetet pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të siguruara nga prona e njëjtë e pasurive të paluajtshme, të cilat janë të regjistruara në regjistrin kadastral me një

shkallë më të lartë prioritare ose pas zbritjes së një pjese proporcionale të detyrimeve që kanë të njëjtën shkallë prioritare si llogaritë e arkëtueshme të bankës përkatëse;

- 3.2.6. Vlera e instrumentit të kolateralit do të jetë vlera e tregut të pasurisë së paluajtshme të përcaktuar nga një vlerësues i pavarur;
- 3.2.7. Banka duhet të ketë të gjitha dokumentet e nevojshme ligjore lidhur me pasurinë e paluajtshme të përdorur si instrument i kolateralit për të arkëtueshmet;
- 3.2.8. Gjatë një marrëdhënie kontraktuale, banka duhet të vazhdojë të monitorojë vlerën e pasurisë së paluajtshme të pranuar si instrument i kolateralit për ekspozimet, minimalisht një herë në vit për pasuritë e paluajtshme komerciale dhe një herë në cdo tri vite për pasuritë e paluajtshme rezidenciale. Banka duhet të kryejë monitorime më të shpeshta të vlerës së pasurisë së paluajtshme kur ka ndryshime domethënëse të kushteve të tregut.

## **Neni 18**

### **Shpalosjet për publikun**

1. Shpalosja për publikun nga banka duhet të promovojnë transparencë dhe krahasueshmëri, duke siguruar informacione në kohë, relevante dhe vendimmarrëse.
2. Shpalosja për menaxhimin e rrezikut kreditor dhe financiar duhet të bëhet në përputhje me SNRF dhe kornizat mbikëqyrëse.
3. Bankat duhet të japin një shpjegim të ndryshimeve të rëndësishme në vlerësimin e HPK nga periudha në periudhë për të përmirësuar cilësinë dhe kuptueshmërinë e informacionit të shpalosur për vlerësimet HPK.
4. Menaxhmenti i bankës duhet të rishikojë rregullisht politikën për dhënie të informacionit për të siguruar që informacioni i shpalosur të vazhdojë të jetë i rëndësishëm për profilin e rrezikut, koncentrimin e produkteve, normat e industrisë dhe kushtet aktuale të tregut.

## **Neni 19**

### **Rishikimi mbikëqyrës**

BQK, si pjesë të aktivitetit të saj mbikëqyrës vlerëson efektivitetin e praktikave, politikave, proceseve dhe procedurave të menaxhimit të rrezikut kreditor të bankës, si dhe metodat e përdorura nga banka gjatë përcaktimit të rezervave për humbjet nga kreditë për matjen adekuate të humbjeve të pritshme kreditore.

## **Neni 20**

### **Raportimi në Bankën Qëndrore të Republikës së Kosovës**

Bankat duhet t'i dorëzojnë formularët e raportimit të BQK-së të përcaktuara nga BQK-ja sipas Rregullores për raportimin e bankave.

## **Neni 21**

### **Dispozitat kalimtare**

Bankat duhet të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e kësaj rregulloreje deri me datën 01 janar 2020.

## **Neni 22**

### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për Bankat.

## **Neni 23**

### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor të Bankave, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 31 gusht 2016, si dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë rregullore.

## **Neni 24**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës